



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: PRANUAR/DORËZUAR:		13 10. 2016	
DATUM: PRILJENJE/DOSTAVLJEN:			
DATE: RECEIVED/SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
10	05	829	8+40

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Udhëzues për Kontrollin e Cilësisë së Auditimeve të Rregullsisë

Prishtinë, Tetor 2016

Shkurtesat e përdorura

AP	Auditori i Përgjithshëm
DeMCA	Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim
DLA	Departamenti Ligjor për Auditim
DMCA	Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim
DMZH	Departamenti për Metodologji dhe Zhvillim
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
PBA	Plani i Brendshëm i Auditimit
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
PJA	Plani i Jashtëm i Auditimit
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

I. Qëllimi dhe baza e Udhëzuesit

1. Ky Udhëzues përbën kornizën e kontrollit të cilësisë, i cili synon të sigurojë që auditimi të kryhet në mënyrë profesionale, me rezultate dhe raporte të cilësisë së lartë.
2. Ky Udhëzues paraqet procedurat për kultivimin dhe rritjen e cilësisë. Aranzhimet specifike për kontrollin e cilësisë duhet të sigurojnë që auditimet janë të dokumentuara si duhet, me kohë, gjithëpërfshirëse - të bazuara në rrezik, të ekzekutuara në mënyrë efikase dhe që i nënshtrohen një procesi efektiv të rishikimit. Auditori i Përgjithshëm duhet të sigurohet se është kryer punë e mjaftueshme dhe e duhur për ta mbështetur opinionin e dhënë.
3. Ky Udhëzues bazohet në Standardin Ndërkombëtar të Kontrollit të Cilësisë (SNKC 1) zhvilluar më tej për sektorin publik në SNISA 40 dhe SNISA 1220.

II. Fushëveprimi i zbatimit dhe fazat e procesit të kontrollit të cilësisë

1. Kontrolli i cilësisë duhet të zbatohet për secilin auditim. Kjo do të thotë përfshirja e procedurave të kontrollit të cilësisë në fazat e planifikimit, punës së auditimit në terren dhe raportimit të auditimit.
2. Kontrolli i cilësisë do të kryhet në dy nivele:
 - Në nivel të departamenteve; dhe
 - Në nivel të divizioneve.
3. Listat kontrolluese të kontrollit të cilësisë janë pjesë përbërëse e masave të kontrollit të cilësisë në të dy nivelet. Ato janë referuar në secilën fazë të auditimit dhe janë përfshirë në shtojcat e këtij Udhëzuesi.

a. Kontrolli i cilësisë në Fazën e Planifikimit të Auditimit

1. Një plan i caktuar i auditimit përgatitet për secilin auditim, i cili është përfshirë në planin vjetor të auditimit. Objektiva e këtij plani të caktuar të auditimit është të sigurohet që:
 - Dëshmitë përkatëse dhe të mjaftueshme janë siguruar për ta mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm;
 - Standardet ndërkombëtare të auditimit janë zbatuar;
 - Vetëm hapat e nevojshëm të auditimit janë kryer.
2. Sipas Doracakut për Auditime të Rregullsisë parashihen fazat e planifikimit në vijim:
 - planifikimi i përgjithshëm i auditimit; dhe
 - planifikimi i detajuar i auditimit.

Hapat specifik sipas fazave janë të përshkruar në Doracakun për Auditime të Rregullsisë.

3. Produkti kryesor i fazës së planifikimit për auditimet e rregullsisë është **Plani i Jashtëm i Auditimit (PJA)**. Ky dokument duhet të vë në pah fushëveprimin e auditimit, përgjegjësitë e ZKA-së dhe entitetit, rreziqet kyçe të auditimit dhe përgjigjet e auditimit ndaj tyre, si dhe informacionin rreth ekipit të auditimit dhe orarit të auditimit. Programet e auditimit përmbajnë procedura specifike të auditimit, të cilat auditori do t'i plotësojë gjatë fazës së punës në terren dhe këto duhet të finalizohen në këtë moment të procesit të planifikimit.

Krahas memorandumit që dërgohet te entiteti, ekipet e auditimit hartojnë edhe **Planin e Brendshëm të Auditimit (PBA)**, në të cilin auditori i përcakton objektivat e auditimit dhe mënyrën se si do të arrihen ato. Ky dokument ofron bazën për punën e planifikuar të auditimit që duhet miratuar dhe njëkohësisht për mbikëqyrjen e progresit dhe të cilësisë. Ai duhet të përmbajë një përmbledhje koncize, që përfshinë vendimet e marra dhe faktorët e rëndësishëm që kanë ndikuar në to gjatë fazës së planifikimit të përgjithshëm dhe atij të detajuar të auditimit, me fokus në ndryshimet që janë bërë në planin e vitit të kaluar.

4. Drejtori i departamentit të auditimit kryen detyrën e përgjithshme të përgjegjësisë së mbikëqyrjes së procesit të planifikimit për të siguruar cilësinë dhe konsistencën si bazë për një auditim efektiv. Kjo detyrë mund të kryhet me rishikimin dhe miratimin e të gjitha letrave të punës dhe veçanërisht PJA dhe PBA, Modelin e Sigurisë së Auditimit/Qasjen e përgjithshme të auditimit dhe programet e ndërlidhura të auditimit (nivelet e propozuara të testimit dhe madhësitë e mostrave), për të siguruar që ato të jenë të plota dhe që vendimet e planifikimit kanë bazë të shëndoshë.
5. Për të ndihmuar në sigurimin që detyrat e planifikimit të auditimit janë kryer në mënyrë të kënaqshme, udhëheqësi i ekipit dhe drejtori i departamentit të auditimit do ta plotësojnë secili nga një listë kontrolluese. Listat kontrolluese të plotësuara (A dhe B si shtojca të këtij Udhëzimi) duhet të vendosen në kapitullin e planifikimit të dosjes së auditimit.
6. Meqenëse puna e cila kryhet në këtë fazë formon bazën për konkluzionet e dhëna, formën dhe përmbajtjen e raporteve të auditimit, vendimet e përgjithshme dhe të detajuara të planifikimit do të rishikohen nga DMCA, menjëherë pas pranimit të dosjes nga drejtori i departamentit të auditimit.
7. DMCA bën rishikimin e dosjes së planifikimit dhe dokumenton punën e kontrollit të cilësisë duke përdorur Listën kontrolluese C. Dosja e planifikimit konsiderohet finale vetëm pasi ekipet e auditimit t'i kenë adresuar çështjet e ngritura nga DMCA, në rast se ka të tilla.

b. Kontrolli i cilësisë në Fazën e Punës së Auditimit në Terren

1. Udhëzuesi në këtë pjesë i referohet auditimit të ndërmjetëm, që kryhet gjatë vitit të cilit i përkasin pasqyrat financiare dhe ka si produkt **Memorandumin e Auditimit** si dhe punës përfundimtare të auditimit që realizohet pas përfundimit të vitit dhe ka si produkt final **Raportin e Auditimit**.
2. Para fillimit të secilit auditim, udhëheqësi i ekipit duhet të sigurojë që:
 - Të gjithë anëtarët e ekipit të auditimit e kanë kuptuar planin e auditimit dhe detyrat që u janë caktuar;

- Secili auditor e ka njohurinë, aftësimin dhe shkathtësitë që kërkohen për kryerjen e detyrave të tyre;
 - Nuk ekziston konflikt i interesit ose ndonjë prej faktorëve që në ndonjë mënyrë mund t'i rrezikojnë parimet e pavarësisë, objektivitetit dhe kompetencës së auditorëve në ekip.
3. Gjatë kësaj faze të auditimit, udhëheqësi i ekipit të auditimit është përgjegjës për:
 - Ofrimin e udhëzimit dhe mentorimit për anëtarët e ekipit lidhur me aspektet e auditimit;
 - Mbikëqyrjen e kryerjes së auditimit dhe përmbushjen e detyrave të auditimit;
 - Rishikimin e punës së kryer, dokumentacionin mbështetës dhe të gjeturat si dhe konkluzionet e propozuara.
 4. Auditimet do të zbatohen në pajtim me planin e miratuar të auditimit. Plani i auditimit do të ndryshohet për çdo rrethanë të paparashikuar që mund të lind gjatë zhvillimit të auditimit, e cila mund të ketë ndikim në pasqyrat financiare nën auditim. Nëse ndryshimi në plan kërkon ndryshime të theksuara në metodologjinë e auditimit, afatin kohor të auditimit ose burime tjera shtesë, atëherë duhet të kërkohet aprovimi nga AP. Ndryshimet e aprovuara do të dokumentohen në kapitullin e planifikimit për dosjen aktuale dhe për çdo ndryshim informohet DMCA.
 5. Ndryshimet eventuale në planin e auditimit të cilat nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare dhe nuk përfshijnë kërkesa për burime shtesë mund të bëhen nga udhëheqësi i Divizionit/NAP me propozimin e drejtorit të departamentit përkatës.
 6. Udhëheqësi i ekipit është përgjegjës për të siguruar që secili anëtar i ekipit i kryen detyrat e planifikuara në mënyrë profesionale dhe kompetente, në pajtim me metodologjinë e caktuar të auditimit. Ai mbështet dhe mbikëqyr punën rreth rreziqeve domethënëse dhe fushave komplekse ose që kërkojnë gjykim dhe përgatit propozimet përfundimtare për planin e auditimit si dhe programet e auditimit që do të shfrytëzohen.
 7. Udhëheqësi i ekipit është përgjegjës për zgjidhjen e dallimeve në gjykimin profesional ndërmjet anëtarëve të ekipit të auditimit. Nëse udhëheqësi i ekipit nuk është në gjendje ta bëjë këtë, çështja duhet të bartet tek drejtori i departamentit të auditimit. Në rast të mospajtimit në mes të udhëheqësit të ekipit dhe drejtorit, vendimi përfundimtar duhet të merret nga udhëheqësi i divizionit përkatës/NAP i cili mund ta konsultoj DMCA, nëse e konsideron të nevojshme.
- Të gjitha diskutimet e tilla dhe zgjidhjet përkatëse do të dokumentohen plotësisht në dosjen e auditimit dhe çështjet materiale me ndikim në opinion raportohen te AP.
8. Secili anëtar i ekipit duhet ta dokumentojë punën e vet. Është përgjegjësi e udhëheqësit të ekipit të auditimit që të sigurojë se ky dokumentacion është kompletuar sipas standardit të duhur.
 9. Pas përfundimit të auditimit të ndërmjetëm ekipi i auditimit duhet të hartoj Memorandumin e Auditimit i cili rishikohet bashkë me dosjen përkatëse nga drejtori i departamentit të auditimit dhe aprovohet nga udhëheqësi i divizionit/NAP dhe i dërgohet entitetit të audituar. Rishikimi ka për qëllim të vlerësoj cilësinë e punës së kryer dhe do të identifikojë çështjet e mbetura që duhet të trajtohen në auditimin final.

DMCA do të për zgjedhë për rishikim një numër të Memorandumeve të Auditimit të cilat do të dërgohen në entitet vetëm pasi ekipet e auditimit t'i kenë adresuar çështjet e ngritura nga DMCA, nëse ka të tilla. Për Memorandumet e Auditimit të cilat do të rishikohen, DMCA do t'a njoftoj drejtorin e departamentit të auditimit në një kohë të arsyeshme para afatit të dorëzimit të entiteti. Për këto rishikime DMCA do të përdorë Listën kontrolluese F.

10. Pas punës përfundimtare në terren dhe para përpilimit të draft raportit të auditimit, udhëheqësi i ekipit plotëson Listën kontrolluese D.
11. Kur udhëheqësi i ekipit e përfundon rishikimin, atëherë dosja rishikohet edhe nga drejtori i departamentit të auditimit përmes Listës kontrolluese E, për të përcaktuar nëse:
 - Auditimi është kryer në pajtim me planin e auditimit;
 - Është zbatuar metodologjia e auditimit (përfshirë ndryshimet sipas nevojës);
 - Rezultatet e auditimit janë dokumentuar në mënyrë adekuate;
 - Objektivat e auditimit janë përmbushur dhe janë pasqyruar në konkluzionet e auditimit;
 - Konkluzionet e paraqitura në letrat e punës janë konsistente me të gjeturat e auditimit dhe e mbështesin opinionin e AP.

c. Kontrolli i cilësisë në Fazën e Raportimit

1. Punët përfundimtare të auditimit përfshijnë një vlerësim objektiv të rezultateve të auditimit si: ri-vlerësimi i materialitetit, vlerësimi i gabimeve dhe pasigurive si dhe kontrolli i cilësisë së versionit final të PFV.
2. Raporti i auditimit duhet të shkruhet në pajtim me qasjen dhe formatin e përcaktuar në Doracakun për Auditime të Rregullsisë dhe duhet të përfundohet brenda afatit të caktuar ligjor. Raporti duhet të shkruhet në mënyrë të qartë, koncize dhe objektive dhe të paraqes në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante.

Të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit duhet të mbështeten me dëshmi përkatëse dhe të mjaftueshme që të arrihet besueshmëria (ashtu si janë dokumentuar në letrat e punës audituese). Rekomandimet e dhëna duhet të jenë të qarta, konsistente me konkluzionet e auditorit dhe të përqendruara në korrigjimin e devijimeve dhe gabimeve të gjetura gjatë auditimit duke e pasqyruar shkakun e këtyre gabimeve.

3. Drafti raporti i auditimit përgatitet nga udhëheqësi i ekipit në bashkëpunim me anëtarët e ekipit të auditimit. Në këtë fazë udhëheqësi i ekipit do ta plotësojë Listën kontrolluese G.
4. Draft raporti i auditimit do të rishikohet nga drejtori i departamentit të auditimit për të siguruar që:
 - Forma dhe përmbajtja e Raportit është në pajtim me standardet dhe formatin e miratuar të raportimit;
 - Raporti pasqyron të gjeturat dhe konkluzionet e rëndësishme të procesit të auditimit dhe ato janë 'të shënjuara' qartë në Raport;
 - Të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet janë konsistente, koncize dhe të qarta;
 - Të gjeturat dhe konkluzionet e mbështesin opinionin e propozuar të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij rishikimi, drejtori i departamentit të auditimit do ta plotësojë Listën kontrolluese H.

5. Nëse ekziston dallim në gjykime profesionale ndërmjet drejtorit të departamentit të auditimit dhe udhëheqësit të ekipit lidhur me çështjet kryesore (për shembull, ndikimi i disa të gjeturave në pasqyrat financiare, zbatimi i standardeve të kontabilitetit, ose llojin e modifikimit të opinionit), atëherë drejtori do ta diskutoj çështjen me DMCA dhe do ta njoftoj udhëheqësin e divizionit përkatës/NAP. Të gjitha korrigjimet, gjykimet e ndryshme profesionale ose ndryshimet në konkluzione dhe rekomandime të cilat paraqiten gjatë rishikimit të draft raportit të auditimit duhet të dokumentohen nga drejtori i departamentit .
6. Pas rishikimit të draft raportit së bashku me dosjen përkatëse nga drejtori i departamentit të auditimit, ai duhet të aprovohet nga udhëheqësi i divizionit/NAP para se t'i dërgohet entitetit të audituar, për rishikim dhe komente.

DMCA do të rishikoj një numër të draft raporteve, përfshirë dosjen e fazës së ekzekutimit. Draft raportet e rishikuara nga DMCA dërgohen në entitet vetëm pasi të jenë adresuar çështjet e ngritura nga DMCA, nëse ka të tilla. Për draft raportet të cilat do të rishikohen, DMCA do t'a njoftoj drejtorin e departamentit të auditimit në një kohë të arsyeshme para afatit të dorëzimit të entiteti. Për këto rishikime DMCA do të përdorë Listën kontrolluese I.

7. Udhëheqësi i ekipit dhe drejtori i departamentit të auditimit do t'i marrin parasysh komentet e bëra nga entiteti i audituar dhe do t'i diskutojnë ato me menaxhmentin e entitetit të audituar, nëse është e nevojshme.

Pas pranimit të komenteve nga entiteti i audituar, do të bëhen korrigjimet e nevojshme në draft raport. Në rast të mospajtimit, komentet e entitetit të audituar në gjetjet e auditorit do t'i bashkëngjiten Raportit final të auditimit.

8. Drejtori i departamentit të auditimit do ta dorëzojë pastaj Raportin të udhëheqësi i divizionit përkatës/NAP për rishikim. Pas rishikimit nga udhëheqësi i divizionit përkatës/NAP, Raporti dorëzohet te Auditori i Përgjithshëm për miratim.

Raporti final i miratuar nga Auditori i Përgjithshëm i dorëzohet entitetit të audituar, institucioneve përkatëse dhe publikohet brenda afatit ligjor.

d. Kontrolli i cilësisë në fazën e përcjelljes

1. Përcjellja e veprimit të entitetit të audituar lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit është pjesë e rëndësishme e procesit të auditimit dhe si zakonisht kryhet si pjesë e fazës së planifikimit të një auditimi. Hollësitë lidhur me përparimin e entitetit të audituar në zbatimin e rekomandimeve të auditimit do të përfshihen në dokumentet e planifikimit të një auditimi. Megjithatë, kur entiteti i audituar të mos jetë subjekt i auditimit vjetor, do të nevojitet të kryhet një detyrë e posaçme audituese varësisht nga rëndësia dhe natyra e rekomandimeve.
2. Qasja për verifikimin se nëse janë zbatuar rekomandimet do të varet nga natyra e dobësive të cilat i shoqërojnë rekomandimet. Në rastet kur problemet janë relativisht të vogla, ku menaxhmenti i pranon rekomandimet dhe ka një plan veprimi për zbatimin e tyre, ekzaminimi mund të bëhet përmes pyetjeve të thjeshta. Në rastet e tjera, udhëheqësi i ekipit

do të planifikojë rishikimin dhe testimin e nevojshëm për të konstatuar që entiteti i audituar i ka ndërmarrë hapat e kërkuara dhe që problemet janë zgjidhur.

3. Veprimet e ndërmarra nga entiteti i audituar të cilat kanë rezultuar me largimin e parregullsive të gjetura nga auditimi paraparak duhet të shënohen në një pjesë të veçantë të raportit të auditimit. Kur entiteti i audituar nuk ka ndërmarrë një veprim adekuat lidhur me rekomandimet e auditimit kjo duhet të ceket në mënyrë të theksuar.

III. Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzues hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.
2. Me këtë Udhëzues njoftohet personeli i ZKA-së.

Besnik Osmani



Auditor i Përgjithshëm

13 tetor 2016

Shtojca 1: Listat Kontrolluese të Kontrollit të Cilësisë

Faza e Auditimit	Lista Kontrolluese	Rishikuesi
Faza e Planifikimit të Auditimit	A	Udhëheqësi i Ekipit
	B	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	C	Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit
Faza së Punës së Auditimit në Terren	D	Udhëheqësi i Ekipit
	E	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	F	Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit (Rishikohet vetëm Memorandumi i Auditimit)
Faza e Raportimit	G	Udhëheqësi i Ekipit
	H	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	I	Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit



Lista kontrolluese A: Kontrolli i Cilësisë në Fazën e Planifikimit të Auditimit

Të plotësohet nga Udhëheqësi i Ekipit

Entiteti i audituar	
Tema	Kontrolli i Cilësisë në Fazën e Planifikimit të Auditimit
Objektivi	Për të siguruar që planifikimi i auditimit është përfunduar dhe është kryer në përputhje me politikat dhe praktikat tona të përcaktuara në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë dhe Udhëzimin përkatës.

Pyetjet në këtë listë kontrolluese kanë të bëjnë me udhëzimin e detajuar të ZKA-s në planifikimin e auditimit.

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
1	Takimi i planifikimit të brendshëm udhëhequr nga Drejtori - A është mbajtur takimi për strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe a është dokumentuar zyrtarisht? Në këtë takim duhet të marrin pjesë Drejtori dhe Udhëheqësi i Ekipit (të tjerët me ftesë të drejtorit, duke përfshirë anëtarët e mëparshëm të ekipit/stafin e auditimit të performancës sipas nevojës). - Aty ku është e aplikueshme, a ka marrë parasysh ekipi i auditimit nëse ekzistojnë gjykime historike të kontabilitetit/ metodologjisë të cilat do të kenë ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat financiare të vitit aktual? Nëse është kështu, a kanë siguruar se dokumentacioni përkatës i cili mbështet këto gjykime është dorëzuar si informacion i rëndësishëm për dosjen e auditimit, që do të vlerësohet dhe përditësohet më vonë në procesin e auditimit (këtu mund të përfshihen dokumentet teknike, dëshmi për ndërlidhje me klientët dhe këshilla nga DMCA).			
2	Aktivitetet e Angazhimit A është përgatitur Letra e Angazhimit për dërgim Udhëheqësit Ekzekutiv të entitetit të audituar, apo letra aktuale e angazhimit a është mbajtur në dosje?			
3	Të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij - A ka përditësuar ekipi i auditimit Formën për Njohjen e Punës, mjaftueshëm për të informuar rreth vlerësimit të rrezikut? A e adreson kjo opinionin, pajtueshmërinë dhe çështjet e qeverisjes së mirë? - A është rishikuar dhe përditësuar kjo qasje si e përshtatshme, në			

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
	fund të fazës së planifikimit të përgjithshëm?			
4	Materialiteti - A janë llogaritur 'nivelet e materialitetit', 'pritjet e gabimit agregat' dhe saktësia e planifikuar? - A është konsideruar materialiteti kualitativ?			
5	Pyetjet për planifikimin e klientit, të kuptuarit e kontrolleve të brendshme dhe testet kalimthi - A janë siguruar kontaktet kryesore për OB për auditimin e ardhshëm? (duke pasur parasysh pyetjet të cilat kërkohen nga SNISA, siç detajohet në rendin e ditës për takimin e planifikimit)? - A e ka përditësuar ekipi të kuptuarit për kontrollin e brendshëm të entitetit, mjaftueshëm për të informuar lidhur me vlerësimin e rrezikut? Kjo mund të përfshijë përditësimin e shënimeve të sistemit të raportimit kyq financiar të klientit dhe sistemeve të ndërlidhura dhe do të kërkojnë ndërmarrjen e testeve kalimthi për të gjitha sistemet të rëndësishme.			
6	Përcaktimi i Komponentëve të Auditimit A janë analizuar komponentët e auditimit si: domethënëse dhe jo domethënëse?			
7	Procedurat paraprake analitike A janë kryer procedurat paraprake analitike, përfshirë të paktën çështjet vijuese: ➤ Identifikimi i rrjedhave të të hyrave dhe shpenzimeve; ➤ masat e performancës kundrejt të cilave është vlerësuar entiteti dhe ndikimi që mund të ketë në rezultatet e raportuara të organizatës; dhe ➤ Krahasoni i buxhetit në nivel të mjaftueshëm për t'i identifikuar të gjitha zërat domethënës që mund të kenë ndikim në qasjen e auditimit kundrejt shifrave të vitit paraprak, duke përfshirë shqyrtimin e trendëve. A është përcaktuar nëse gjetjet tregojnë rreziqet shtesë domethënëse apo faktorë të rrezikut për auditimin?			
8	Qasja e testimit fillestar			

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
	A është përmbledhur qasja e propozuar e testimit; ➤ Duke treguar shqyrtimin e të gjitha pohimeve që duhet të adresohen, duke përfshirë pohimin e rregullsisë; ➤ Ku puna për pajtueshmëri është e bazuar në rrezik dhe janë marrë informata të plota nga rishikimi i ligjeve dhe rregulloreve; dhe ➤ Programi i qeverisjes së mirë a është arsyetuar?			
9	Procedurat e vlerësimit të rrezikut • A ka përcaktuar dhe dokumentuar ekipi modelin e sigurisë së auditimit i cili e arsyeton sigurinë e vetvetishme dhe i identifikon rreziqet domethënëse? • A tregon plani i testimit të rreziqeve domethënëse përgjigjen e duhur ndaj rreziqeve domethënëse dhe a i identifikon faktorët e rrezikut?			
10	<u>Të përgjithshme</u> • A kanë siguruar hapat e planifikimit të përgjithshëm shqyrtimin e duhur të çështjeve të mashtrimit dhe auditimeve të TI-së; dhe a janë rreziqet e identifikuara të dokumentuara në mënyrë të qartë? • Për ta maksimizuar efikasitetin e auditimit: ➤ A i është dhënë vëmendje të mjaftueshme potencialit për të vendosur për mbështetje në Auditimin e Brendshëm? ➤ A është marrë parasysh përdorimi i IDEA-s? ➤ A janë përdorur maksimalisht Procedurat Substanciale analitike? ➤ A ka i tërë dokumentacioni i planifikimit konkluzion përmbledhës, se si ndikon puna e ndërmarrë e planifikuar në qasjen e auditimit? ➤ A është rishikuar i gjithë dokumentacioni i planifikimit nga ana e Drejtorit, para se të hartohen programet e auditimit?			
11	Programet e auditimit • A janë programet e auditimit të plota dhe a reflektojnë një qasje të rrezikut të bazuar në opinion, pajtueshmëri dhe qeverisje dhe a janë konsistente– për punën e auditimit për opinion dhe pajtueshmëri – me A3.9? • A janë përshtatur programet standarde të auditimit për të siguruar			

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
	që e pasqyrojnë qasjen më efektive dhe relevante të auditimit për të audituarin? A ofrojnë testet e opinionit siguri të auditimit për secilin pohim pa dyfishime? A janë të gjitha testet e kontrollit në përputhje me rezultatet e testeve kalimthi?			
12	Buxheti - A pasqyron plani kohor i vendosur kohën e nevojshme për zbatimin e qasjes së planifikuar të auditimit? - A përfaqëson kjo shfrytëzimin efektiv të kohës së stafit, e që pasqyron edhe një pjesë të mostrave të kalkuluara?			
13	Miratimi i programeve të auditimit nga Drejtori A është rishikuar dhe miratuar secili program i auditimit nga Drejtori?			
14	Plani i Auditimit - A ka hartuar ekipi i auditimit një plan të auditimit për të reaguar ndaj rreziqeve domethënëse (në PTRS) dhe fushat e auditimit që nuk janë ndikuar nga rreziqet domethënëse? Kjo duhet të nxjerrë në pah: ➤ Aty ku testet e kontrollit janë planifikuar me një përmbledhje të kontrolleve kyçe mbi të cilat do të vendoset mbështetja; ➤ Kërkesat për testime substanciale, përfshirë Procedurat Analitike Substanciale (PAS) sipas nevojës; dhe ➤ Bazë për fushëveprimin e testeve të auditimit të pajtueshmërisë.			
15	Pikat rishikuese nga Drejtori/Udhëheqësi i ekipit dhe miratimi i Planit Konfirmimi se të gjitha pikat rishikuese të Udhëheqësit të ekipit dhe Drejtorit janë marrë parasysh dhe se procedurat e planifikuara të auditimit janë miratuar nga Drejtori.			
16	Plani i Auditimit /planifikimi i projektit - A ka hartuar dhe dorëzuar ekipi i auditimit Planin e Jashtëm të Auditimit në bazë të Planit të brendshëm të Auditimit? - A është pajtuar ekipi i auditimit me klientin për hollësitë se si do të kryhet auditimi? Kjo nuk duhet të përfshijë detaje të qasjes			

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
	sonë të planifikuar të testimit, por normalisht duhet të mbulojë: afatet kohore të auditimit: ➤ Listat për kërkesë të informacioneve; ➤ Kërkesat e të dhënave; dhe ➤ Çdo aspekt tjetër të planit të auditimit që varet nga koordinimi me klientin. • A ri-vlerësohen të gjitha vendimet e planifikimit para se të dërgohet Plani jashtëm i Auditimit?			
17	Administrimi • A janë përfunduar dhe dokumentuar pikat në vazhdim: ➤ Buxheti i përgjithshëm për sa i përket kohës me stafin e auditimit i caktuar për kryerjen e punëve që e pasqyron inputin faktik të nevojshëm, të stafit. ➤ Deklaratat e pavarësisë së anëtarëve të ekipit.			

Lista kontrolluese plotësuar nga:	Data:
Lista kontrolluese rishikuar nga:	Data:

Lista kontrolluese B: Kontrolli i Cilësisë në Fazën e Planifikimit të auditimit

Të plotësohet nga drejtori i auditimit

Emri i klientit	
Tema	Kontrolli i Cilësisë në Fazën e Planifikimit të Auditimit
Qëllimi	Të sigurohet që planifikimi i auditimit është kompletuar dhe kryer në pajtim me politikat dhe praktikat tona të përcaktuara në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë dhe në Udhëzuesin përkatës

Pyetjet në listën kontrolluese kanë të bëjnë me udhëzuesin e detajuar të ZKA-it për planifikimin e auditimit

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
1	Planifikimi i takimit Nga drejtori dhe udhëheqësi i ekipit kërkohet ta mbajnë një takim planifikues që ta përcaktojnë Strategjinë e Përgjithshme të Auditimit. A janë dokumentuar formalisht rezultatet e këtij takimi në Planin e Brendshëm të Auditimit, dhe a i reflektojnë çështjet kyçe që janë diskutuar?			
2	Strategjia e Përgjithshme e Auditimit Nga Drejtori kërkohet që ta rishikojë dhe ta aprovojë Strategjinë e Përgjithshme të Auditimit. Kjo duhet të përfshijë një rishikim të Planit të Brendshëm të Auditimit, Planit të Testimit të Rreziqeve Domethënëse, Raportit të Planifikimit të Auditimit dhe dokumente të tjera të planifikimit ashtu si e sheh të nevojshme Drejtori. Nënshkrimi i kësaj liste kontrolluese, tregon se ju i keni rishikuar këto gjëra dhe jeni të kënaqur me: • rigozitetin e aplikuar në procesin e planifikimit*; • vlerësimin i materialitetit (duke e përfshirë materialitetin kualitativ); • planifikimin e reagimeve të planifikuara ndaj Rreziqeve Domethënëse dhe Faktorët e Rrezikut(përfshirë rreziqet e parregullsisë dhe të mashtrimit); dhe • Qasja e përgjithshme ndaj përdorimit të kontrolleve dhe ndaj orarit për kryerjen e punës së auditimit. Kjo duhet të mbështetet nga testet kalimthi të një thellësie dhe cilësie të mjaftueshme. Çështjet specifike me të cilat duhet të jeni i kënaqur përfshijnë: • A janë testet e kontrollit të propozuar konsistente me kontrollet e identifikuara në testet kalimthi?			

Nr.	Pyetja	Po	Jo	Ref. e L.P./Koment
	• A është plani i testimit të rreziqeve domethënëse i kompletuar? • A janë audituar mjaftueshëm të gjitha pohimet? • A i është dhënë konsideratë e mjaftueshme çështjeve të qeverisjes së mirë? • A është qasja e përgjithshme e bazuar në rrezik, dhe a jeni i kënaqur se kalkulimet fillestare të madhësisë së mostrës janë përcaktuar saktë? • A demonstroi qartë formulari i Njohjes e Punës njohuri rreth klientit, dhe a e drejton qasjen e auditimit? • A është azhurnuar tërësisht kjo formë për vitin aktual, duke u mbështetur nga një analizë adekuate e dokumenteve strategjike dhe operacionale? • A janë përshtatur programet e auditimit për ta siguruar qasjen më efektive dhe relevante të auditimit (programet standarde të auditimit janë vetëm pikënisje)? • A kanë qenë të nevojshme azhurnimet e programeve të auditimit pas rishikimit që keni bërë para fillimit të auditimit të ndërmjetëm? *"rigoroziteti" ka për qëllim të reflektoj thellësinë dhe cilësinë e procesit të planifikimit. Drejtori duhet të jetë i kënaqur se kjo është adekuate për të siguruar një auditim të planifikuar mirë i cili i adreson të gjitha objektivat e auditimit. Kjo duhet të bazohet në një formë gjithëpërfshirëse të "njohjes së biznesit" e cila mundëson identifikimin e të gjitha rreziqeve potenciale.			
3	Miratimi i Planit të Auditimit Plani i Auditimit e pasqyron Strategjinë e Përgjithshme të Auditimit si dhe rezultatet e Procedurave të kryera të Vlerësimit të Rrezikut. Si Drejtor i Auditimit, a jeni i kënaqur se ky plan ofron siguri të mjaftueshme mbi të gjitha transaksionet, bilanci dhe shpalosjet në pasqyrat financiare; si dhe a përfshin procedurat e domosdoshme për t'i arritur objektivat e SNISA-ve dhe a i shton vlerë entitetit të audituar?			
4	Administrata A është propozimi për buxhetim të stafit i përshtatshëm (që e pasqyron fushëveprimin e punës së propozuar) dhe a i përjashton ai shtesat për "jo-efikasitet" ose "menaxhim të dobët të alokimit të stafit".			
5	Rishikimi i Drejtorit A janë adresuar plotësisht nga ekipi pikat e rishikimit të ngritura nga drejtori?			

Lista kontrolluese e plotësuar nga:	Data:
Lista kontrolluese e rishikuar nga:	Data:

Lista kontrolluese C: Rishikimi i Cilësisë në Fazës së Planifikimit të Auditimit

Të plotësohet nga DMCA

Emri i klientit	
Tema	Kontrolli i Cilësisë në Fazës së Planifikimit
Qëllimi	Të sigurohet që planifikimi i auditimit është kompletuar dhe kryer në pajtim me politikat dhe praktikat tona të përcaktuara në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë dhe në Udhëzuesin përkatës

Udhëzime për përfundimin e kontrollit të cilësisë për fazën e planifikimit

Fokusi i rishikimeve të cilësisë

Çdo rishikim duhet të fokusohet në:

- Një rishikim të përzgjedhur të përputhshmërisë së auditimit me standardet profesionale dhe metodologjinë e auditimit të ZKA-s, duke përfshirë rishikimin e fokusuar si përgjigje e planifikuar për adresimin e rreziqeve kyçe të auditimit;
- cilësinë e dëshmive të mbledhura nga ekipi për identifikimin e rreziqeve kyçe të auditimit;
- çdo mundësi për përmirësimin e dokumentimit dhe efikasitetin e qasjes së auditimit për ciklin e ardhshëm të auditimit; dhe
- një rishikim të Planit të Brendshëm Auditimit për verifikimin e konsistencës me shabllonin e dakorduar.

Procesi i rishikimit të Cilësisë

Pritet që çdo rishikim i cilësisë të përmbajë hapat në vijim:

- Drejtori dhe udhëheqësi i ekipit duhet t'u ofrojë Departamentit për Menaxhimin e Cilësisë dokumente para se të fillojë rishikimi – këtu duhet të përfshihen: pasqyrat e vitit të mëparshëm, Plan i Jashtëm i Auditimit, plani i testimit të rrezikut domethënës (PTRD), plani i testimit të fushës së llogarisë, një shembull i programit të auditimit që mbulon fushën e të hyrave apo shpenzimeve dhe programin ciklik të auditimit të pajtueshmërisë. Ekipi mund ta plotësojë këtë informacion me çfarëdo dokumenti shtesë që ata besojnë se ju ndihmojnë DMCA-së gjatë rishikimit;
- DMCA mban një takim fillestar me drejtorin dhe udhëheqësin e ekipit për të rishqyrtuar aspektet kyçe të auditimit (nëse është e nevojshme);
- DMCA kryen rishikimin e detajuar, duke e kompletuar listën kontrolluese duke e mbushur listën e të gjeturave në pjesën e prapme të listës kontrolluese me çështjet e identifikuar.

- DMCA do t'i diskutojnë çështjet/pyetjet me Drejtorin dhe Udhëheqësin e Ekipit dhe do ta japë përgjigjen në kolonën e fundit, duke deklaruar se çështja është qartësuar apo nëse ajo është konfirmuar. Ata duhet të sigurojnë rezultate indikative nga rishikimi dhe të përgatisin komentet e përgjithshme;
- Lista kontrolluese përfundimtare do të ndahet me AAP-në relevant.

Orari

Rishikimi e cilësisë për planifikim do të zgjasin rreth 2 ditë për një kompletim mesatar dhe duhet të kryhen deri në gjysmën e dytë të nëntorit të çdo viti, ose në ndonjë datë tjetër të specifikuar, sipas pajtimit. Dita e secilit ekip do të konfirmohet nga Drejtori përkatës. Rezultatet e përmbledhura do t'i ofrohen Ekipit të Menaxhmentit të Lartë çdo vit.

Klasifikimi i rezultateve

DMCA do ta klasifikojë çdo të gjetur si të gjetur të pajtueshmërisë, të dokumentacionit përfshirë të gjeturat e efikasitetit dhe të praktikës së mirë.

Çështjet e pajtueshmërisë do të ndahen më tutje në çështje që konsiderohen si:

- serioze (niveli 1);
- domethënëse (niveli 2); apo
- të rregullta (niveli 3).

	Përshkrimi
Mospërputhshmëria me Metodologjinë/ Udhëzimet	
Niveli 1	Është një çështje e definuar si një pyetje e cila mund të tregojë se përcaktimi i një opinioni auditimi të përshtatshëm është në rrezik p.sh. mbulimi i pamjaftueshëm i auditimit të rreziqeve domethënëse.
Niveli 2	Është një çështje e definuar si një pyetje, e cila paraqet: një jo-pajtueshmëri domethënëse me SNISA apo me doracakun e auditimeve të rregullsisë / kërkesat e pakos së letrave të punës.
Niveli 3	Është një çështje e definuar si një pyetje ku opinioni me gjasë nuk do të rrezikohet, por çështja paraqet një mangësi në dëshmi apo se si ajo është paraqitur në dosje apo është më shumë ndonjë jo-pajtueshmëri e vogël me SNISA apo me doracakun e auditimeve të rregullsisë (çështjet teknike) / kërkesat e pakos së letrave të punës.
Dokumentacioni	
Niveli 4	Fushat për përmirësim në dokumentimin e punës së auditimit në mbështetje të planifikimit.
Praktika e Mirë	
Niveli 5	Fushat të cilat i demonstrojnë praktikën më të mirë të punës së auditimit; qasjet që demonstrojnë përfitime në efikasitet; apo të tjera

A	Letër Informimi	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është Jo, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
A.1	A përmban dosja e auditimit: - letër informimin; - udhëzimin administrativ dhe - Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve?			

B	Planifikimi i Auditimit	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është Jo, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
	Takimi fillestar për planifikim			
B.1	- A është mbajtur takimi i dokumentuar për dosjen e planifikimit nga drejtori, udhëheqësi i ekipit, dhe stafi tjetër relevant duke përfshirë stafin e përfshirë më parë në auditim dhe stafin e auditimit të performancës, nëse së fundi ata kanë kryer punë në lidhje me entitetin e audituar? - A i adreson kjo diskutimet e pritura, përfshirë çështjet e ngritura, qasjen e auditimit për opinionin dhe punën rreth pajtueshmërisë dhe qeverisjes së mirë? (Dokumentet kësaj AL/AL.3)			
	Të kuptuarit e veprimtarisë			
B.2	A është ndërmarrë vizita në terren si pjesë e procesit të planifikimit? - Nëse Jo - cili është arsyeja? - Nëse Po - a ka zgjidhur njafueshëm për të mundësuar kryerjen e punës së planifikimit?			

B	Planifikimi i Auditimit	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është Jo, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
B.3	- A përmban dosja dëshmi të mjaftueshme për të demonstruar se ne e kemi përditësuar të kuptuarit tonë të entitetit në Formën për Njohtjen e Punës (A1.4) deri në një shkallë të mjaftueshme në mënyrë që të informojmë mirë auditimin e 20XX? (Shënim: kjo formë është azhurnuar për auditimet 2016 dhe të gjitha aspektet duhet të adresohen plotësisht). - A është rezultati i vlerësimit një pasqyrë e qartë e të gjitha çështjeve kyçe të auditimit për tu shqyrtuar gjatë procesit të auditimit në kuadër të punës për opinion, pajtueshmëri dhe qeverisje? A i përfshinë kjo të gjitha rreziqet domethënëse dhe rreziqet tjera? - A ka ndër-referencë të çështjeve kyçe të auditimit me programet e auditimit ku janë adresuar ato? (Rishikimi i dokumentacionit të siguruar – Buxhetet/ Procesverbalet/ Plani i Prokurimit, etj. – Në kontekstin e qeverisjes së mirë, dokumentet e pritura strategjike do të duhej të merreshin. Këto dokumente pritet të jenë të analizuar dhe jo vetë të marra p.sh Vetëvlerësimi i MFK-së).			
Udhëzim shtesë - Këqymri me kujdes indikatorët për të cilët janë përdorur dokumentet e vitit të kaluar, p.sh. vitet nuk janë azhurnuar ose përfshihen fakte që nuk kanë lidhje me vitin aktual dhe janë të vjetër/ jo-relevante. Ekzistenca e dobësive të tilla nuk duhet të pranohet si 'çështje teknike' por si dëshmi e cilësisë së dobët të planifikimit/rishikimit të cilësisë së dobët. Kur t'i shqyrtojmë planet strategjike dhe dokumentet tjera të tilla, mungesa e çfarëdo vlerësimi të pëmbledhur të përmbytjes/ndikimit të auditimit do ta sugjerojë një proces të planifikimit si të pakompletuar.				
Materialiteti				
B.4	- A janë përcaktuar materialiteti dhe preciziteti i planifikimit në përputhje me udhëzimet e ZKA -s dhe me synim tek pjesët potencialisht materiale për nga natyra dhe konteksti? (Dokumentet kyçe A3.1 (versioni i azhurnuar për auditimet 2016) A3.3 plus forma e re për planifikim të auditimit të brendshëm). - Nëse nuk ka çështje materiale të identifikuara, a është arsyetuar kjo			

B	Planifikimi i Auditimit	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është JO, theksojo ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Nivelit 5 barten në shtojcë
	pritet që të mbështetet mbi to,			
B.7	A i merr dokumentacioni për kontrollet e përgjithshme në konsideratë kontrollet e përgjithshme të TL-së dhe kontrollet e tjera për të na mundësuar vlerësimin e mjedisit të përgjithshëm të kontrolleve në hollësi të mjaftueshme, për të bërë një vlerësim të bazuar në dëshmi. <i>(Dokumentitë krye A 3.1)</i>			
	Procedurat paraprake analitike dhe përcaktimi i komponentëve të auditimit			
B.8	A janë ndërmarrë procedurat paraprake analitike (dokumenti krye A 3.5), të cilat shqyrtojnë edhe të hyrat edhe shpenzimet si dhe shqyrtojnë: • Buxhetin kundrejt realizimit aktual në vit; • Buxhetin kundrejt realizimit të vitit të mëparshëm; dhe • Të dhëna të tjera relevante, p.sh indikatorët e performancës. • Kur shifrat e llogarive pasqyrojnë një proces konsolidimi, p.sh agjencitë ose rajone gjeografikisht të ndryshme apo departamente, a është marrë parasysh rishikimi në nivel jo agregat (jo grupor)? • A është aplikuar një qasje sistematike për përcaktimin e komponentëve të rëndësishme dhe jo të rëndësishme? • Në qoftë se një komponent me vlerë mbi materialitetin performancës është përcaktuar si jo të rëndësishme – a është dokumentuar qartë baza për këtë. (A3.4) • Nëse janë identifikuar komponente 'jo domethënëse, rishiko Procedurat Analitike Preliminare (PAP) për të përcaktuar nëse mund të identifikohet ndonjë parregullsi – p.sh në kuadër të të hyrave të komunat, duke testuar 'rigorizitetin' me të cilin është			

B	Planifikimi i Auditimit	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është Jo, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit
	zbatuar PAP?				Niveli 5 barten në shtojcë
	Qasja e testimit fillestar, procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe modeli i sigurisë së auditimit				
B.9	- A ka marrë ekipi njohuri adekuate rreth kornizës së autoriteteve që kanë ndikim në rregullsi të entitetit duke i identifikuar të gjitha ligjet dhe rregulloret relevante që ndikojnë në organizatën buxhetore dhe duke treguar ndikimin e tyre në qasjen e auditimit – më saktësisht punën që nevojitet për të adresuar pohimin e rregullsisë dhe për të zhvilluar një program auditimi të pajtueshmërisë? - Shiko nëse ekziston një lidhje ndërmjet sistemeve jo domethënëse dhe testimit për pajtueshmëri dhe nëse baza për pajtueshmëri ka startuar nga viti i kaluar? - A është e qartë se është marrë parasysh çfarëdo ligji apo rregullore e re që ka hyrë në fuqi në 12 muajt e fundit? - A janë A3.7.8 të detajuara mjaftueshëm për të demonstruar se është bërë rishikim i nivelit të duhur?				
	Udhëzime shtesë: Rishikuesit duhet ta përdorin krahasimin në mes të organizatave të ngjashme buxhetore kur e shqyrtojnë B.9. A është marrë në konsideratë një rang i ngjashëm i ligjeve dhe rregulloreve? A janë konkluzionet e njëjta nga çdo ligj/rregullore kyçe - të ngjashme? Nëse nuk ka krahasim të drejtpërdrejtë, duhet të kihen parasysh çështjet e prishme të pajtueshmërisë				
B.10	A është hartuar si duhet fushëveprimi i procedurave të ndërmarta për vlerësimin e rrezikut për të identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse dhe faktorët e rrezikut? (Ref.: A1.4, A3.1, A3.6) Mbani mend: Këto procedura duhet të përfshijnë një vlerësim të duhur si të mjedisit të entitetit të audituar ku përfshihet korniza e kompetencave ashtu edhe të kontrollit të tij të brendshëm. A është kompletuar plani i testimit të rrezikut domethënës (PTRD)? Në veçanti:				

B	Planifikimi i Auditimit	Poz./lo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është JO, theksoje ndikimin e kësaj. Sllih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
	- A ka rrezik në PTRD për secilin rrezik të identifikuar në Planin e Jashëm të Auditimit duke e përfshirë edhe rrezikun e supozuar të shkeljeve nga menaxhmenti? - A janë identifikuar kontrollet që operojnë mbi rreziqe? dhe - A ka ndonjë rrezik domethënës me ndikim në buxhetin e organizatës, i cili nuk është identifikuar nga ekipi (pa ndonjë shpjegim të duhur në dosje)? Në qoftë se nuk është identifikuar asnjë rrezik domethënës, konsideroj rreziqet e përbashkëta, të identifikuara në auditimet e ZKA -s, dhe konsidero shkallën në të cilën dokumentacioni i zbutë këto rreziqe, p.sh. plotësia e pasurive. - A janë faktorët e rrezikut të identifikuar gjithëpërfshirës dhe të arsyeshëm?			
B.11	Për secilin rrezik domethënës: - A ka punuar ekipi për dizajnimin dhe implementimin e kontrolleve? Nëse nuk është kryer asnjë punë, a është dhënë ndonjë arsytim i përshatshëm? - A është formuluar ndonjë përgjigje e përshatshme për të fituar siguri të mjaftueshme për rrezikun? (p.sh. nëse ka Rreziqe Domethënës rreth prestioneve për të arritur buxhetet, a është mbështetja në kontrollet buxhetore apo mbështetja e PA ndaj buxhetit e përshatshme?) - A janë dizajnuar dhe përfshirë testet për t'u përgjigjur rrezikut në mënyrë adekuate? - A ka ndonjë përgjigje specifike shtesë për secilin rrezik specifik jo vetëm lidhjet me testet standarde. - A ndonjë dallim të qartë mes rrezeqeve që përhapen dhe atyre			

B	Planifikimi i Auditimit	Po/Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është JO, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
	specifike? • Aty ku janë propozuar teste substanciale, a janë dokumentuar qartë madhësitë e mostrave dhe burimet e mostrave?			
B.12	• A janë kompletuar modeli i sigurisë së auditimit dhe plani i testimit të fushës së llogarisë? Në veçanti: Modeli i Sigurisë së Auditimit (A3.4) • A janë përfshirë të gjitha fushat domethënëse të llogarisë? • A ka kuptim Modeli i Sigurisë së Auditimit dhe a është konsistent me modelin e ZKA-s? • A është shpjeguar baza për nivelin e sigurisë së vetvetishme? • Testimi i përmbljedhjes së fushës së llogarisë • A është dokumentuar në mënyrë të qartë përgjigja e testimit d.m.th. a ekzistojnë lidhjet edhe me testet e kontrolleve aty ku është e përshatshme edhe me testet substanciale si dhe niveli i testimit të nevojitur për efektivitetin e kontrolleve? • A janë përgjigjet e testeve të duhurat, a i adresojnë të gjitha pohimet relevante? • A ka boshllëqe të dukshme në testimet e planifikuara? • Deri në çfarë niveli është marrë parasysh mbështetja në auditimin e brendshëm? A është justifikuar në dosje qasja e zbatuar? • A janë përcaktuar kërkesat për burime për adresimin e testeve të planifikuara?			
B.15	Kur ekipi planifikon të mbështetet në kontrolle: • A janë planifikuar kontrollet, në të cilat planifikohet mbështetja, karshi pohimeve? • A e përfshin testimi i planifikuar testimin efektiv i cili reflekton shpeshësinë e kryerjes së kontrollit?			

B Planifikimi i Auditimit		Po jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është JO, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit
B.13	A është marrë në konsideratë sa duhet opsioni për të: • Përdorur IDEA-n; dhe • Maksimizuar përdorimin e procedurave analitike substanciale (PAS). • Ngritur efikasitetin e auditimit. Nëse jo, a e ka arsyetuar ekipi qasjen e aplikuar?			
Udhëzim shitesë: Dokumentacioni rreth përgjigjeve ndaj rreziqeve domethënëse dhe faktorëve të rrezikut dhe kontrolleve të identifikuara duhet të jenë plotësisht të kompletuara dhe konsistente me fushat e tjera të planit të auditimit.				
Rishikimi i Njohjes së Punës				
B.14	• Pasí janë përfunduar hapat e planifikimit të përgjithshëm, a ka marrë ekipi parasysh nevojën për të azhurnuar formularin e Njohjes së Punës (A.1.4) për të siguruar se të gjitha vendimet kryesore mbi planifikimin janë dokumentuar?			
Rishikimi nga drejtori				
B.15	• Konfirmimi se drejtori i ka rishikuar të gjithë formularët e planifikimit të përgjithshëm PARA hartimit të programeve të auditimit dhe konfirmimi kalkulimin fillestar të mostrës/numrin e testeve të kontrollit.			
Programet e Auditimit				
B.16	• A janë Programet e Auditimit në formatin e kërkuar nga ZKA? • A janë vetëm testet e kontrolleve të domosdoshme të detajuara (që lidhen me Modelin e Sigurisë) dhe të ndërlidhura me të gjitha pohimet e auditimit dhe konsistente me kontrollet e identifikuar në testet kalimthi? • A ofron testimi substancial mbulim përkatës përkundrejt të gjitha			

B	Planifikimi i Auditimit	Po Jo (kur përgjigja është Po, jep vlerësim kualitativ dhe konsidero theksimin si 'praktikë e mirë'. Kur përgjigja është JO, theksoje ndikimin e kësaj. Shih shembujt mëposhtëm)	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
	pohimeve të auditimit por pa teste të dylshita ? - A është mbështetur auditimi i pajtueshmërisë mbi një programin ciklik të bazuar në rrezik dhe qartësisht ndryshe nga testet e opinionit për pohimin e rregullisë? - A i adresojnë programet e auditimit të qeverisjes dobësitë/çështjet specifike që janë adresuar në fazën e planifikimit?			
	<u>Udhëzim shtesë:</u> - Për auditim të opinionit - Të gjitha pohimet e auditimit duhet të mbulohen dhe këto duhet në mënyrë të saktë t'i adresojnë pohimet e 'të hyrave/shpenzimeve' ose pohimet e 'bilancit'. Nëse një pohim i auditimit mbulohet nga më shumë se një test, atëherë duhet të ketë një arsyë të vlefshme për këtë ose kjo mund të konsiderohet si indikator i testimit të tepruar.			
	Buxheti			
B.17	- A bazohet koha e ndarë për auditim në burimet e disponueshme?			
	Plani i Jashtëm të Auditimit			
B.18	- A i përmbush Plani i Jashtëm Auditimit kërkesat shabllonit të ZKA -s dhe a ofron informacion të mjaftueshëm rreth qasjes së auditimit (sidomos në lidhje me rreziqet domethënëse), afatet kohore, ekipin e auditimit dhe informacionin që kërkohet nga Klienti? - A është ai konsistent me Planin e Brendshëm të Auditimit? - A janë reflektuar ndryshimet e bëra në qasjen e auditimit gjatë fazës së planifikimit të detajuar përmes dokumentacionit të azhurnuar të planifikimit?			
	Udhëzim shtesë: Ky duhet të funksionojë si një dokument i veçantë, ku shpjegohen plotësisht zhvillimet e klientit, profili i rrezikut dhe qasja për auditimin e planifikuar. Ai duhet të jetë konsistent me dokumentacionin përkatës në dosjen e planifikimit.			

C	Rishikimi	Po/Jo nuk është bërë punë shtesë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit niveli 1-4 barten në shtojcë	Çfarëdo, niveli i pikë rishikimit Niveli 5 barten në shtojcë
C.1	Rishikimi nga udhëheqësi i ekipit i fazës së planifikimit - A e ka plotësuar në tërësi udhëheqësi i ekipit Listën kontrolluese "A" - Kontrolli i cilësisë në fazën e planifikimit ?			
